



Komisioni i  
Pavarur i  
Kualifikimit

## NJOFTIM PËR SEANCËN DËGJIMORE PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. PALI DEÇOLLI



28/04/2023

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore në datën 27.4.2023, për subjektin e rivlerësimit, z. Pali Deçolli bazuar në ligjin nr. 84/2016, vendosi:

Konfirmim në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Pali Deçolli, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Vendimi, i arsyetuar me shkrim, nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Firdes Shuli, znj. Xhensila Pine relatores, z. Olsi Komici anëtar do t'i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ky vendim, mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall sot, në datën 28.4.2023.

*Infomacioni i mësipërm është marrë në faqen e njoftimeve të KPK, në linkun: <https://kpk.al/njoftim-per-seancen-degjimore-per-subjektin-e-rivleresimit-z-pali-decolli/09/>*